- **Bashki e Vogel:** formati me 3-shifra (XXX), te perfituara nga zberthimi me nje rend vijues i elementit nr.7 (pas shifres e dyte) te seciles seri.
- **Njesi administrative:** formati me 3-shifra (XXX), te perfituara nga zberthimi me nje rend vijues i elementeve nr. 8, 9 dhe 10 (pas shifres se dyte) te seciles seri.

Formati i NSN, per te plotesuar vleren e kerkuar (3) te treguesit SN/NB, ne kufijte e ketij Plani Numeracioni duhet te jete me 8-shifra.

Perfshirja ose jo e me shume se nje bashki nen nje NDC te formatit me 3-shifra (XXX) kushtezohet nga numri i popullsisë se seciles prej tyre, dhe ndermerret ne plotesim te rekomandimit per te minimizuar sasine e NDC-ve.

Ne ato raste kur nje NDC i perket me shume se nje njesie administrative ose bashkie, diferencimi i seciles bashki do te behet nepermjet shifres se pare ( $Y_1$ ) te SN.

Per eU\_i b e Tiranes: Bashkise Baze i caktohet NDC e formatit me 1-shifer (X→4), dy Bashkite e Vogla (Kamez dhe Vore) perfshihen ne nje NDC te formatit 2-shifror (XX→46) duke u diferencuar nepermjet shifres se pare ne diapazonin e SN, ndersa njesite administrative identifikohen te grupuara ne tre NDC te formatit me 2-shifra (XX→47, 48 dhe 49), perseri duke u diferencuar ne nivel njesie nepermjet shifres se pare ne diapazonin e SN.

Per te bere efektive NDC e formatit me 2-shifra te parashikuara per Bashkite e Voglaž serite e diapazonit te SN per Bashkine baze kufizohen deri te seria 5. Sipas ketij opsioni, arrihen vlerat e meposhteme te treguesit SN/NB:

	<i>NSN me 7-shifra</i>	<i>NSN me 8-shifra</i>
• Bashkia Baze–Tirane:	1.16	11.59
• Bashkia e Vogel–Kamez:	2.27	22.72
• Bashkia e Vogel–Vore:	2.34	23.41


Caktimi i eUeY Yqe do te perfshihen brenda te njejtës seri numerike (pra qe do te kene te njejtën shifer te pare te NDC-ve perkatese) eshte bere mbi bazen e vendosjes dhe fqinjesise gjeografike, gjithmone nen kufizimet qe per çdo seri te mundeshme per perdorim (perjashtuar serine 4) te rezultojë:

- a) Numri i Bashkive Baze qe kane nevoje per NDC me 2-shifra ..... ≤ 4
- b) Numri i Bashkive Baze qe kane nevoje per NDC me 3-shifra ..... ≤
- c) Numri i Bashkive te Vogla (te gjitha kane NDC me 3-shifra) ..... ≤ 10
- ç) Numri i NDC-ve me 3-shifra njesite administrative (te gjitha kane NDC me 3-shifra). ≤ 30

*Shenim :* Keto kufizime rrjedhin direkt nga sasia e elementeve te çdo serie te destinuar per njesite administrative (Bashki Baze dhe Bashki te Vogla ) dhe njesie administrative.

Ne kete zgjidhje, te gjitha njesite administrative, pavaresisht nese jane te Bashkive Baze apo Bashkive te Vogla, perfaqsojne zona te veçanta numeracioni.

Ne menyre skematike nje eU<sub>f</sub> çfardo mund te paraqitet:



*Njesi administrative te Numeracionit (me NDC<sub>4</sub>-NDC<sub>9</sub>), nuk jane zberthyer*

Per te ilustruar menyren e formimit te numrit, per llojet e ndryshme te komunikimeve, sipas llogjikes se ketij varianti, per formatin me 8-shifra te NSN, po caktojme ne menyre te rastit :

NDC <sub>1</sub> ⇒	22	NDC <sub>4</sub> ⇒	272	NDC <sub>7</sub> ⇒	275
NDC <sub>2</sub> ⇒	261	NDC <sub>5</sub> ⇒	273	NDC <sub>8</sub> ⇒	276
NDC <sub>3</sub> ⇒	271	NDC <sub>6</sub> ⇒	274	NDC <sub>9</sub> ⇒	277

Nga ana e saj NDC<sub>3</sub> përfshin 3 nendarje, të cilat i diferencojnë nëpërmjet shifrës së parë të SN. Duke u kufizuar deri tek NDC<sub>3</sub>, do të kishim në këtë rast :

	NDC	SN
- Bashkia Baze .....	22	200000 ÷ 999999
- Bashkia e Vogel .....	261	20000 ÷ 99999
- Njësi administrative (K-1) .. .. .	271 .....	20000 ÷ 39999
- Njësi administrative (K-2) .....	271 .....	40000 ÷ 69999
- Njësi administrative (K-3) .....	271 .....	70000 ÷ 79999
- Njësi administrative (K-4) .....	271 .....	80000 ÷ 99999

dhe nëse do të konsiderojmë si abonent thirrës atë me NSN ⇒ 271 55555 (pra një abonent të nendarjes së dytë (K-2) të njësisë së parë administrative të eUf\_i h (të identifikuar me anë të NDC<sub>3</sub>), do të kishim këto raste të numer formimit të një abonenti tjetër të thirrur:

<i>Vend-ndodhja e abonentit</i>	<i>Seria numerike që i duhet</i>
<i>te thirrur</i>	<i>e formoje abonenti thirrës</i>

**a) Brenda eUf\_i h formon "0" + NDC + SN**

- 1) Brenda bashkise ..... "0" + "NDC" + SN (44444)
- 2) Në një bashki tjetër (psh K-3), por brenda të njëjtes njësi administrative... "0"+NDC+SN(77777)
- 3) Në një bashki tjetër, që ndodhet në një njësi tjetër administrative (psh me NDC<sub>3</sub>)...273 66666
- 4) Në Bashkinë e vogël (psh BV-1) ..... 0 261 66666
- 5) Në Bashkinë Baze ..... 0 22 666666

**b) Jashtë eUf\_i h (formon Prefiks Kombëtar+NSN=0+NDC+SN)**

- 1) Në një bashki ..... 0 573 66666
- 2) Në Bashkinë e vogël (psh BV-1) ..... 0 561 66666
- 3) Në Bashkinë Baze ..... 0 52 666666

**c) Jashtë Vendit (formon Prefiks Nderkombëtar+NSN=00+CC+NDC+SN)**

- 1) Athinë-Greqi ..... 00 30 1 6644961



## Karakteristikat permbljedhese

1. Kriteret organizative baze te kesaj zgjidhjeje jane:
  - Secila njesi administrative – Bashki Baze e 12 eUfeY Yte kete nje NDC.
  - Secila njesi administrative – Bashki te vogla ne pikpamje te numeracionit konsiderohen te perfshira ne nje bashki te eU\_i hperkates dhe identifikohen me NDC nga i njeji spekter numerik ku zgjidhen edhe NDC e njesive administrative.
  - Zonat e numeracionit (Bashki e Vogel/Bashki ) kushtezohen nga numri i banoreve dhe fqinjësia gjeografike.
2. Parashikohet shfrytezimi i 9 elementeve (nga i dyti deri tek i dhjeti) te mundeshem per shfrytezim per NDC gjeografike ne 5 serite (2, 3, 4, 5 dhe 8). Seria 9 (elementi i dyte deri tek i dhjeti) jane te lire. Serite 6, 7 jane plotesisht ne dispozicion te NDC jo-gjeografike. Elementet e pare te serive (X0) ku  $X=2\div 9$  jane ne dispozicion te Kodeve te Shkurter per sherbimet jo-gjeografike, per sherbimet/rrjeta te perzier, per rrjeta jo-telefonike apo sherbime te tjera.
3. Pavec grupimit te 12 eUfeY Y te vendit ne 1 Rajon qe diferencohen nga njeri tjetri nepermjet shifres se pare te NDC, ne perputhje me serine e zgjedhur, njesite dhe bashkite brenda qarkut do te diferencohen dhe identifikohen nepermjet shifres se dyte te NDC dhe konkretisht:
  - **njesi administrative – Bashki Baze:** shifra e dyte e NDC eshte 1, 2, 3, 4, dhe 5.
  - **njesi administrative – Bashki e vogel:** shifra e dyte e NDC eshte 6, 7, 8 dhe 9.
4. Formati i NDC-ve do te jete
  - njesi administrative –Bashki Baze** formati me 1-shifer (X) vetem per bashkine baze te Tiranes; te tjerat me 2-shifra (XX) dhe me 3-shifra (XXX)
  - njesi administrative –Bashki e Vogel:** formati me 2-shifra (XX) vetem per BV te Tiranes; te tjerat-formati me 3-shifra (XXX).
  - njesi administrative – Bashki :** formati me 2-shifra (XX) vetem per zonat e Tiranes te tjerat-formati me 3-shifra (XXX).
5. Formati me 7-shifra i NSN nuk mundeson realizimin e vleres se kerkuar  $SN/SN \geq 3$ , prandaj imponohet planifikimi i formatit me 8-shifra te NSN, me Skeme Uniforme te Numeracionit (format konstant i  $NSN=NDC+SN$ ).
6. Seria 1 ne diapazonin e NDC lihet e lire per transformim te Llojit te Planit te Numeracionit (nga Plan i Hapur ne Plan te Mbyllur).

7. Sasia e zonave te numeracionit, sasia dhe formati perkates i NDC-ve:

Vendi ndahet ne 170 zona numeracioni, secila me NDC te vecante, nga te cilat:

	Ndarjet administrative dhe te numeracionit	Gjithsej (NDC)	Sasia sipas formatit		
			X	XX	XXX
a.	Njesia administrative (Bashki Baze)	36	1	14	21
b.	Njesia administrative (Bashki )	20			20
c.	Zona mikse (Bashki te Vogla)	7	-	1	6
ç.	Njesia administrative (Bashki te Vogla)	107		2	10
<b>Gjithsej:</b>		<b>170</b>	<b>1</b>	<b>17</b>	<b>152</b>

8. Nder 54 elementet e matrices 2-shifrore te mundsheme per perdorim si NDC gjeografike, mbeten 11 elemente rezerve (rreth 20 %), dhe konkretisht elementet 23, 25, dhe 91 ÷ 99. Gjithashtu, pas zberthimit te elementeve X1, X6, X7, X8 dhe X9 te seciles seri (ku X=2, 3, 5, 8) dhe perfitimit te 200 elementeve 3-shifrore, mbeten rezerve 48 elemente 3-shifrore (rreth 24 %), te cilat identifikohen ne “Tabelen perbledhese te NDC-ve sipas serive” te perfshire ne materjalin e plote “kodet e Drejtimit Kombetar (NDC) per zonat gjeografike”. Rezerva gjithashtu identifikohen edhe ne njesine administrative brenda zonave te numeracionit, ku sipas rastit dhe ne vartesi te numrit te bashkive dhe popullsise se tyre, mbeten seri te plota ose pjesore te pa shfrytezuara (rezerve) te cilat paraqiten ne tabelat perkatese te detajimit te NDC-ve per secilin eU\_.
9. Pervec caktimit te NDC-ve, detyrimi i AKEP shtrihet edhe ne shifren e pare te SN (Y<sub>1</sub>) per njesite administrative dhe bashkite, te cilat ne aspektin funksional perafrohen si Kode Lokale (*Local Code*).
10. Ne kendveshtrimin e tranzitimit te thirrjeve dhe rrugesimit te tyre ne drejtimin e caktuar, te gjithe centralet, pavaresisht nese mbulojne njesi administrative (duke filluar qe nga nje bashki e vetme) apo bashkite, pervec aftesise per te tranzituar thirrjet e adresuara ne zona te tjera numeracioni brenda vendit (komunikimi kombetar, te cilat paraprihen nga “0”-prefiksi kombetar “*National Prefix*”) dhe ato te adresuara jashte vendit (komunikimi nderkombetar, te cilat qe paraprihen nga “00”-prefiksi nderkombetar “*International Prefix*”), ne ato raste kur me shume se nje njesi administrative (Bashki e vogel apo Bashki baze) kane NDC te perbashket, centralet duhet te jene “te hapur” per te rrugesuar thirrjet nepermjet identifikimit te *shifres se pare* te numrit telefonik (SN) se abonentit te kerkuar. Gjithashtu secili nga centralet duhet te perpunoje dhe adresoje thirrjet me shifer te pare “1” ne diapazonin e SN-ve, te cilat sikunder kemi trajtuar perfaqsojne Kode te Shkurter (trajtuar gjeresisht ne pjesen “Kodet e Shkurter te serive 0 dhe 1”).
11. Menyra e konceptimit dhe e konkretizimit te tranzitimit te thirrjeve ka rendesi, jo vetem ne aspektin e modelimit te skemes se tranzitimit ( me nje apo me shume nivele hierarkike te tranzitimit ), apo ne ate te paisjeve teknike (ne te dy komponentet perberes “hardware” dhe

“software” ), por edhe ne aspektin ekonomik, pasi marrëdhëniet financiare midis operatoreve, dhe operatoreve me abonentet, mund të ekzekutohen vetëm nëse krahas tarifave perkatese (te cilat përbejnë vetëm një faktor të relacionit ekonomik operator-abonent dhe operator-operator ), do të mundësohet matja e trafikut në të gjitha aspektet dhe në të gjitha nivelet. Në të kundert, marrëveshjet e interkoneksionit midis operatoreve të telekomunikacionit, ose nuk mund të arrihen, ose do të jenë të pabazuara dhe të pabesueshme për palet. Në këtë këndvështrim, është i implikuar edhe sistemi i “billing-ut”.

12. Identifikimi i vend-ndodhjes së abonentit nëpërmjet kësaj numri të tij bëhet nëpërmjet shifrës së dytë të NSN (ose shifrës së dytë të NDC). Nëse ajo është 1, 2, 3, 4 ose 5 – abonentit i përket njësisë administrative “Bashki Baze”; nëse është 6 – abonentit i përket njësisë administrative “Bashki e Vogël”; dhe nëse është 7, 8, 9 – abonentit i përket njësisë “Bashki”. Për serinë 4 të destinuar për Tiranën, ku NDC e bashkisë baze është 4, identifikimi bëhet në shifrën e dytë të NSN. Nëse ajo është 2, 3, 4, 5 dhe 6 ajo përfaqëson shifrën e parë të SN së një abonentit që ndodhet në Bashkinë Baze; nëse është 7 përfaqëson shifrën e dytë të NDC së një abonentit që ndodhet në Bashkitë e Vogël (Kamez ose Vore), të cilat bashkërisht përbejnë zonën e numeracionit të identifikuar me NDC “47”; nëse shifra e dytë është 8 ose 9, ajo tregon se abonentit ndodhet në pjesën e mbetur të njësisë administrative të eUf\_i h Identifikimi i mëtejshëm i bashkisë së vogël bëhet në shifrën e tretë që vijon grupin 2-shifror “47”, 48 dhe “49”.

**KODET E SHKURTER NE DIAPAZONIN E NDC-ve PER  
SHERBIMET JO-GJEOGRAFIKE, SHERBIME/RRJETA TE PERZIERA,  
RRJETA JO-TELEFONIKE**

**KODET E SHKURTER NE DIAPAZONIN E NDC PER SHERBIMET JO-JEOGRAFIKE**

Kodet e Shkurter të shërbimeve jo-gjeografike përdoren për të identifikuar dhe diferencuar:

- |    |                                 |                                   |
|----|---------------------------------|-----------------------------------|
| a. | Sherbimin “Telefona pa pagesë”  | <i>(Freephone Service)</i>        |
| b. | Sherbimin “Ndarje të ardhurash” | <i>(Shared Revenue Service)</i>   |
| c. | Sherbimin “Ndarje të kostos”    | <i>(Shared cost Service)</i>      |
| ç  | Sherbimin “Celular”             | <i>(Cellular Service)</i>         |
| d. | Sherbimin “Përxhëng”            | <i>(Paging Service)</i>           |
| e. | Sherbimin “Numra Personal”      | <i>(Personal Numbers Service)</i> |

Kodet e Shkurter të këtyre shërbimeve jo-gjeografike duhet t’i japin palet tërësisht informacion paraprak për tipin dhe karakteristikat e shërbimit. Nder këto karakteristika, përmendim si më kryesor informacionin për strukturën tarifore dhe detyrimin financiar në ngarkim të kërkuarit, por gjithashtu synohet dënia edhe e informacioneve të tjera dytesore, të tilla si: nëse shërbimi është komunikim një apo dy drejtëshe; nëse thirrja do të marrë përgjigje nga operatori apo nga ndonjë sistem automatik; nëse shërbimi është vetëm për të rritur apo për çdo mëshe etj.

Keto kode jane ne interes edhe te vete rrjetave te telekomunikacionit, pasi perdorimi i tyre mundeson:

- rrugezimin e thirrjeve ne rrjeta te dedikuara qe ofrojne sherbime te caktuara,
- rrugezimin e trafikut masiv nepermjet rrugeve te dedikuara te transmetimit me synim parandalimin e tejkalimit te kapaciteteve,
- bllokimin e thirrjeve nderkombetare ne sherbimet me ndarje te ardhurash,
- bllokimin e thirrjeve nga abonente te caktuar ne sherbimet vetem per te rritur, etj.

Nuk eshte e detyrueshme qe çdo sherbim jo-gjeografike te kete kodin e vet te shkurter, te ndryshem nga te gjitha te tjeret. Mundet qe dy sherbime te ndajne te njejtin kod te shkurter.

## **1. Klasifikimi i kodeve te shkurter te sherbimeve jo-gjeografike ne serite perkatese.**

Ne perputhje me rekomandimet e ETO-s (Lidhja nr.1), kodet e shkurter te sherbimeve jo-gjeografike te mesiperme jane te tipit Kode Aksesit (*Access Codes*). Ne perkufizim te pergjithshem, Kodet e Aksesit jane pjesa e pare e nje prefiksi, ose e nje numri telefonik.

Per klasifikimin e kodeve te shkurter te sherbimeve jo-gjeografike ne serite perkatese, vendet europiane, dhe per me shume, ato qe planifikojne ndryshime ne Planin e tyre Kombetar te Numeracionit, i referohen eksperiences se vendeve me te zhvilluara dhe rekomandimeve te Komunitetit European dhe strukturave te specializuara ne fushen e telekomunikacioneve qe operojne ne kuader te KE. Trajtimi dhe percaktimet e meposhteme behen mbeshtetur pikerisht ne kete kend veshtrim.

### **\* Sherbimi “Telefona pa pagese” (*Freephone Service*)**

Per identifikimin dhe diferencimin e ketij sherbimi, rekomandohet perdorimi i Kodit te Shkurter ne serine **8**. Ne rastin e formatit me 3 shifra, diapazoni i kombinacioneve 80X (ku  $X=1 \div 9$ ) lihet i lire ne dispozicion te zgjerimit perspektiv te ketij sherbimi, per diferencimin brenda ketij grupi te sherbimeve, si dhe ne interes te sherbimit nderkombetar me ndarje te kostos (*International Shared Cost Service*).

### **\* Sherbimi “Ndarje te ardhurash” (*Shared Revenue Service*)**

Per identifikimin dhe diferencimin e ketij sherbimi, rekomandohet perdorimi i Kodit te Shkurter ne serine **9**. Ne rastin e formatit me 3 shifra, diapazoni i kombinacioneve 90X (ku  $X=1 \div 9$ ) lihet i lire ne dispozicion te zgjerimit perspektiv te ketij sherbimi, si dhe per diferencimin brenda ketij grupi te sherbimeve.

### **\* Sherbimi “Ndarje te kostos” (*Shared Cost Service*)**

Nuk ka ndonje percaktim te konsoliduar per serine ku duhet te vendoset Kodi i Shkurter per identifikimin dhe diferencimin e ketij sherbimi.

Duke vleresuar ecurine gjate viteve te fundit te sherbimeve te telekomunikacionit te klasifikuara ne grupin e sherbimeve me ndarje te kostos, paramendohet nje rritje e metejshme e rendesise se

tyre, kjo edhe per faktin se ato paraqiten si nje alternative ndaj sherbimeve te telefonave pa pagese (*Freephone Services*). Ne keto kushte, do te ishte normale per vendin tone qe per sherbimet e klasifikuara ne grupin e sherbimeve me ndarje te kosos, Kodi i Shkurter te caktohet ne serine **8**, ku ndodhet edhe Kodi i Shkurter per *Freephone Services*. Pare ne tendencen e transformimit te kodit te shkurter te sherbimeve me ndarje te kosos ne kod te shkurter te harmonizuar (HESC), rekomandohet qe si HESC per keto sherbime te perdoret nje nder kombinacionet **8X<sub>1</sub>X**, duke cilesuar kushtin **X<sub>1</sub>≠0**.

**\* Sherbimi “Celular” (*Cellular Service*), Sherbimi “Pexhing” (*Paging Service*) dhe Sherbimi “Numra Personal” (*Personal Numbers Service*)**

Pavaresisht se nuk ka ende nje percaktim te konsoliduar per serite nga duhet te zgjidhen Kodet e Shkurter per te diferencuar dhe identifikuar keto sherbime, rekomandohen si nje oportunitet i preferueshem serite 6 dhe 7.

Kodet e shkurter te sherbimeve jo-gjeografike ne Shqiperi, ne parim duhet te zgjidhen perkatesisht si me poshte:

- Sherbimi “Telefona pa pagese” (*Freephone Service*) -**8X** ose **80X** (ku  $X=0$ )
- Sherbimi “Ndarje te ardhurash” (*Shared Revenue Service*) -**9X** ose **90X** (ku  $X=0$ )
- Sherbimi “Ndarje te kosos” (*Shared cost Service*) -**8X** ose **8X<sub>1</sub>X**  
(ku  $X_1 \neq 0$  dhe  $X=0 \div 9$ )

(Alternative paresore **808**, nese nuk ka konflikt)

- Sherbimi “Celular” (*Cellular Service*) -**6X<sub>1</sub>** ose **6X<sub>1</sub>X<sub>2</sub>**  
(ku  $X_1 \neq 0$  dhe  $X_2 \neq 0$ )<sup>(8)</sup>
- Sherbimi “Pexhingu” (*Paging Service*) -**6X<sub>3</sub>** ose **6X<sub>3</sub>X<sub>4</sub>**  
(ku  $X_3 \neq X_1 \neq 0$  dhe  $X_4 \neq X_2 \neq 0$ )<sup>(8)</sup>
- Sherbimi “Numra Personal” (*Personal Numbers Service*) -**7X** ose **7XY**  
(ku  $X=0 \div 9$  dhe  $Y=0 \div 9$ )

(Opsion i mundshem eshte  $X=0$  dhe  $Y=0$ )

Ne lidhje me formatin e ketyre kodeve te shkurter per vendin tone, pra per te zgjedhur midis formateve te mundeshme me 2 apo 3 shifra, si dhe per vlerat konkrete te X dhe Y ne perberje te tyre, duhet te konsiderojme rekomandimet qe kemi trajtuar, dhe rezulton qe kodet e shkurter te sherbimeve jo-gjeografike te trajtuar te jene:

- Sherbimi “Telefona pa pagese” (*Freephone Service*) - **800**
- Sherbimi “Ndarje te ardhurash” (*Shared Revenue Service*) - **900**
- Sherbimi “Ndarje te kosos” (*Shared cost Service*) - **808**<sup>(9)</sup>
- Sherbimi “Celular” (*Cellular Service*) - **6X<sub>1</sub>** (ku  $X_1 \neq 0$ )<sup>(10)</sup>
- Sherbimi “Pexhingu” (*Paging Service*) - **6X<sub>3</sub>** (ku  $X_3 \neq 0$ )<sup>(10)</sup>
- Sherbimi “Numra Personal” (*Personal Numbers Service*) - **700**

Sipas kesaj zgjedhje, rezulton se formati (gjatesia) e kodeve te aksesit te sherbimeve jo-geografike eshte **XX** (dy shifra) per rastin e sherbimive te levizeshme (Celular dhe Pexhing), dhe **XXX** (tre shifra) per sherbimet e tjera (Telefona pa pagese, Ndarje te ardhurash, Ndarje te kostos dhe Numra personal).

Natyrshem lind pyetja: “Sa duhet te jete formati (gjatesia) maksimale e serise se shifrave (prefiksa apo numra telefonik ) qe vijojne kodet e aksesit te sherbimeve jo-geografike?”

Kesaj pyetje mund t’i pergjigjemi duke patur parasysh kufirin maksimal prej **8** shifrash te formatit (gjatesise) se Numrit Sinjifikativ Kombetar–N(S)N (*National Significant Number*) sipas ketij Plani Kombetar Numeracioni qe po konfigurojme (trajtuar ne “Tabela e Alokimit te Kodeve te Shkurter te Sherbimit”.

Duke respektuar, pavaresisht operatorit, edhe parimin e unifikimit te skemave te numeracionit, formati i serise numerike qe do te vijojte kodet e aksesit te sherbimeve jo-geografike te mesiperme, duhet te jete:

- Per sherbimin “Telefona pa pagese” (*Freephone*) -deri ne 5 shifra
- Per sherbimin “Ndarje te ardhurash” (*Shared Revenue*) -deri ne 5 shifra
- Per sherbimin “Ndarje te kostos” (*Shared Cost*) -deri ne 5 shifra
- Per sherbimin “Celular” (mobile-i levizshem) -me 7 shifra<sup>(11)</sup>
- Per sherbimin “Pexhingu” (*Paging*) -e lire  
(E kushtezuar nga kapaciteti i kerkuar.- Opsion i mundshem formati i Celularit me 7 shifra)
- Per sherbimin “Numra Personal” (*Personal Numbers*) -deri ne 5 shifra

Elementet e tjere te serise “6” dhe “7” (gjithsej 16) jane lene te lire ne dispozicion te kodeve te shkurter te sherbimeve jo-geografike.

## **KODET E SHKURTER PER SHERBIME/RRJETA TE PERZIERA.**

Ne “Kodet e Shkurter–Seria 0 ÷ 1” te Planit Kombetar te Numeracionit, si dhe Aneksin Nr.1 bashkelidhur cilesohet se ne kete kategori te sherbimeve/rrjetave perfshihen:

<i>Lloji i sherbimeve/rrjetave</i>	<i>Tipi i Kodit te Shkurter</i>
1. Bartesat ( <i>Carriers</i> ) .....	Prefiks
2. Rrjeta per Qellime Specifike ( <i>Network-Specifics Purpose</i> ) .....	Kod Aksesi
3. Paraqitja e Identifikimit te Linjes Thirrese “CLIP” ( <i>Calling Line Identification Presentation</i> ) dhe Kufizimi (Anullimi) i Identifikimit te Linjes Thirrese “CLIR” ( <i>Calling Line Identification Restriction</i> ) .....	Numer i Shkurter ose Kod Aksesi
4. Posta Zanore ( <i>Voice Mail</i> ) .....	Kod Aksesi
5. Rrjeta Private Virtuale “VPNs” ( <i>Virtual Private Networks</i> ) ....	Kod Aksesi

## 1. Bartesat (*Carriers*)

Sikunder kemi trajtuar ne Pjesen e I-re “Kodet e Shkurter–Seria 0÷1”, bartesat identifikohen dhe kapen nepermjet Prefiksit te Zgjedhjes se Bartesit “CSP” (*Carrier Selection Prefix*) i cili perbehet nga dy pjese: CSP=CAC+CIC, te cilat perkatesisht perfaqsojne:

CAC                    -Kodi i Aksesit te Bartesit (*Carrier Access Code*)

CIC                    -Kodi i Identifikimit te Bartesit (*Carrier Identification Code*)

Paveresisht se Zgjedhja e Bartesit nuk aplikohet aktualisht ne Shqiperi, ne Planin e Numeracionit qe po trajtojme jane parashikuar **formati** dhe **hapesirat numerike** te CAC dhe CIC, perkatesisht:

CAC                    →     10     (formati 2–shifra)

CIC                    →     AB     (formati 2–shifra, ku A=0÷9, dhe B=0÷9)

Formati i plote i CSP rezulton 10AB, duke krijuar 100 kombinacione te ndryshme ne diapazonin 1000÷1099, te cilat mundesojne identifikimin ne nivel kombetar deri te 100 bartesave te ndryshem. Ky kapacitet, ne kuader te koncepteve kohore te ketij Plani Numeracioni, gjykojme se eshte i mjaftueshem.

Perdorimi i zgjedhjes se bartesit si ne parim, ashtu edhe ne llojin e procedures (alternatives) qe do te zgjidhet per t’u aplikuar (“**Bartes i paracaktuar**”–*Default Carrier*; “**Zgjedhje ne çdo thirrje**”–*Call by Call Selection*; “**Parazgjedhje**”–*Preselection*; apo “**E Kombinuar**” (ndermjet tre te mesipermeve)–*Combination*), per momentin mund te anash kalohen, duke e shtyre trajtimin e plote per nje kohe te mevoneshme.

Gjithashtu cilesojme se perdorimi i CSP eshte i pakushtezuar nga lloji i Planit te Numeracionit (Plan i Hapur apo i Mbyllur), por roli i CSP eshte evident per krijimin e nje mjedisi konkurrues te ndershem dhe ekuivalent per operatorët, si dhe nje opsion shume favorizues per konsumatorët ne tregun alternativ dhe konkurrues te telekomunikacioneve.

## 2. Rrjeta per Qellime Specifike (*Network-Specifics Purpose*)

Perdorimi i Kodeve te Shkurter (te tipit Kode Aksesit) per keto rrjeta eshte i dobishem per shfrytezimin komode te serive numerike (pjesë te planit te numeracionit), te cilat jane percaktuar ne nivel kombetar. Kjo mund te behet nepermjet shifrave te para (qe ne kete rast mund te konsiderohen si Kode Aksesit) te kodeve te shkurter, te cilet mund te kene qellime te ndryshme ne rrjeta te ndryshme telekomunikacioni, duke lehtesuar njohjen (identifikimin) e tyre.

Sipas praktikës europiane per kete kod te shkurter zgjedhja e Kodit te Aksesit per keto rrjeta/sherbime do te behet duke konsideruar:

- (a) Zgjedhja e tyre te behet ne diapazonin e NDC-ve, ne serine “7”, e cila se bashku me serine “6” eshte e planifikuar ekskluzivisht vetem per sherbimet/zonat jo-gjeografike.
- (b) Kodi i Shkurter te jete i tipit “Kod Aksesit” me format 3-shifror.
- (c) Kodi i Aksesit te zgjidhet ne diapazonin  $7X_1X_2$  (ku  $X_1 \neq 0$  dhe  $X_2 = 0 \div 9$ ).

Me keto paracaktime, Kodin e Aksesit per “Rrjeta per Qellime Specifike” e zgjedhim nder elementet qe perfitohen duke zberthyer me nje rend elementin e dyte te serise (elementin **71**, i cili nuk ka impakt me shfrytezimin aktual te matrices ne diapazonin e NDC-ve), dhe konkretisht e caktojme **711**.

Formati i numrit vijues duhet te respektoje limitin maksimal me 8-shifra te Planit te Numeracionit. Ne kete menyre, formati maksimal i numrit vijues eshte me 5-shifra (YYYYY), i cili mundeson deri 100.000 kombinacione numerike.

Per AKEP rezulton e detyrueshme qe caktimi (*alokimi*) i ketij Kodi Aksesit per operatorët te behet pasi te argumentohet perfshirja e nje sherbimi te caktuar telekomunikacioni ne kete kategori Rrjeta/sherbimesh.

## 3. Paraqitja e Identifikimit te Linjes Thirrese “CLIP”(Calling Line Identification Presentation) dhe Kufizimi Anullimi i Identifikimit te Linjes Thirrese “CLIR” (Calling Line Identification Restriction)

CLIP dhe CLIR perfaqsojne sherbime suplementare te ofruara nga operatorët, pra ne nje kuader me te gjere ato mund te konsiderohen te perfshira ne sherbimet e operatorit. Ato konkretizohen me kode te shkurter (te tipit “numer i Shkurter” ose “Kod Aksesit”). Keshtu psh, duke aktivizuar CLIR, abonenti eshte ne gjendje te mbroje privacy-in e tij,



pasi perjashton prezantimin (çfaqjen) e numrit të tij përpara abonentit të thirrur, i cili ka aktivizuar paraprakisht CLIP-in. Në parim ETSI ka parashikuar për këto qëllim përdorimin e simboleve (\*) dhe (#) të tastierës. Në kushtet kur përdorimi i këtyre simboleve është në studim e sipër, dhe kur aparatet telefonike multifrekuence nuk okupojnë 100% të numrit të përgjithshëm të aparateve telefonike, për CLIP/CLIR mund të përdoren edhe kode të shkurtra. (Përcaktimi i plote për CLI në rregulloren e numeracionit)

Sipas praktikës europiane për këto kod të shkurtra zgjedhja e Kodit të Shkurtra për këto rrjeta/shërbime do të bëhet duke konsideruar:

- (a) Zgjedhja e tyre të bëhet në diapazonin e SN-ve, në serinë “1”, e cila është e destinuar për shërbimet e operatorit.
- (b) Kodi i Shkurtra të jetë i tipit “Kod Aksesi” me format 3-shifror.
- (c) Kodi i Aksesit të zgjidhet duke “ndarë” (splituar) një ndër elementet e lire 3-shifrore të kësaj serie (referuar tabelës së detajuar të zberthimit të serisë “1”, Pjesa e parë – “Kodet e shkurtra të serive 0-1”).
- (ç) Kodet e Shkurtra për CLIP dhe CLIR të jenë të jenë të tipit “Kod Aksesi” me format 3-shifror, të vijuar me një shifër me qëllim që të diferencojnë secilin nga funksionet CLIP dhe CLIR, pra formati i plote i CLIP/CLIR të jetë me 4-shifra.

Me këto paracaktime, Kodin e Aksesit për “CLIP dhe CLIR” e përfitojmë duke zberthyer me një rend elementin **181**, pra:

**CLIP** ⇒ **1811** (ku 181–është Kod Aksesi; 1–është shifër identifikimi për shërbimin e CLIP)

**CLIR** ⇒ **1812** (ku 181–është Kod Aksesi; 2–është shifër identifikimi për shërbimin e CLIR)

*Shënim:* Kodi i Aksesit i zgjedhur 181 ka alternativa të tjera të mundshme.

#### **4. Posta Zanore(Voice Mail)**

Niveli aktual i studimit teorik dhe aplikimit praktik në Europë e ka përfshirë këto kategori kryesisht në Shërbimet jo-gjeografike (përfshijtur Italinë që e përfshin në Shërbimet e Operatorit). Si rrjedhojë, edhe akses kodit përkatës është zgjedhur në diapazonet e parashikuara për këto shërbime.

Sipas praktikës europiane për këto kod të shkurtra zgjedhja e Kodit të Aksesit për këto rrjeta/shërbime do të bëhet duke konsideruar:

- (a) Zgjedhja e tyre të bëhet në diapazonin e NDC-ve, në serinë “7”, e cila së bashku me serinë “6” është e planifikuar ekskluzivisht vetëm për shërbimet/zonat jo-gjeografike.

- (b) Kodi i Shkurter te jete i tipit “Kod Aksesit” me format 3-shifror.
- (c) Kodi i Aksesit te zgjidhet ne diapazonin  $7X_1 X_2$  (ku  $X_1 \neq 0$  dhe  $X_2 = 0 \div 9$ ).

Me keto paracaktime, Kodin e Aksesit per “Posta Zanore” e zgjedhim nder elementet qe perfitohen duke zberthyer me nje rend elementin e dyte te serise (elementin 71 ), dhe konkretisht e caktojme **712**.

Formati i numrit vijues duhet te respektoje limitin maksimal me 8-shifra te Planit te Numeracionit. Ne kete menyre, formati maksimal i numrit vijues eshte me 5-shifra (YYYYY), i cili mundeson deri 100.000 kombinacione numerike.

Per AKEP rezulton e detyrueshme qe alokimi i ketij Kodi Aksesit per operatoret (si pjese e kushteve te Licences/autorizimeve apo Rregullave te pergjitheshme) te behet pasi te argumentohet perfshirja e nje sherbimi te caktuar telekomunikacioni ne kete kategori Rrjeta/sherbimesh.

## 5. Rrjeta Private Virtuale “VPNs”(Virtual Private Networks)

Edhe ne kete rast, niveli aktual i studimit teorik dhe aplikimit praktik ne Europe e ka perfshire kete kategori ne Sherbimet jo-gjeografike. Si rrjedhoje, edhe kodi aksesit perkates eshte zgjedhur ne diapazonet e parashikuara te NDC-ve per sherbime jo-gjeografike.

Sipas praktikës europiane per kete kod te shkurter zgjedhja e Kodit te Aksesit per keto rrjeta/sherbime do te behet duke konsideruar:

- (a) Zgjedhja e tyre te behet ne diapazonin e NDC-ve, ne serine “7”, e cila se bashku me serine “6” eshte e planifikuar ekskluzivisht vetem per sherbimet/zonat jo-gjeografike.
- (b) Kodi i Shkurter te jete i tipit “Kod Aksesit” me format 3-shifror.
- (c) Kodi i Aksesit te zgjidhet ne diapazonin  $7X_1 X_2$  (ku  $X_1 \neq 0$  dhe  $X_2 = 0 \div 9$ ).

Me keto paracaktime, Kodin e Aksesit per “Rrjeta Private Virtuale” e zgjedhim nder elementet qe perfitohen duke zberthyer me nje rend elementin e dyte te serise (elementin 71 ), dhe konkretisht e caktojme **713**.

Formati i numrit vijues duhet te respektoje limitin maksimal me 8-shifra te Planit te Numeracionit. Ne kete menyre, formati maksimal i numrit vijues eshte me 5-shifra (YYYYY), i cili mundeson deri 100.000 kombinacione numerike.

Per AKEP rezulton e detyrueshme qe alokimi i ketij Kodi Aksesit per operatoret (si pjese e kushteve te Licences/autorizimeve apo Rregullave te pergjitheshme) te behet pasi te argumentohet perfshirja e nje sherbimi te caktuar telekomunikacioni ne kete kategori Rrjeta/sherbimesh.

## KODET E SHKURTER PER RRJETA JO-TELEFONIKE.

Ne "Kodet e Shkurter–Seria 0-1" te Planit Kombetar te Numeracionit eshte cilesuar se ne kete kategori te sherbimeve/rrjetave perfshihen:

<i>Lloji i sherbimeve/rrjetave</i>	<i>Tipi i Kodit te Shkurter</i>
1. Rrjetat e te dhenave ( <i>Data Networks</i> ).....	Kod Aksesi
2. Interneti .....	Kod Aksesi
3. Video tekst ( <i>Video text</i> ) .....	Kod Aksesi

Per te tre llojet e mesiperme te rrjetave jo-telefonike, eshte karakteristike se aksesit ne rrjetat perkatese normalisht realizohet nga paisje fundore inteligjente (te tilla si PC–*Personal Computer*), te cilat, krahasuar me tipet e tjera te paisjeve fundore kane superioritet absolut ne pikepamje te menyres se formimit te numrit (formim dhe transmetim digital) dhe shpejtesise perkatese. Ne kete kuader, pavaresisht se sasia e shifrave vijuese te aksesit kodit kerkohet te jete minimalja e mundeshme (ne respektim te parimit te pergjithshem), ne fund te fundit, ajo mbetet direkt vetem funksion i kapacitetit te kerkuar te kombinacioneve te nevojeshme per te bere diferencimin e operatoreve, por njekohesisht pa tejkaluar ne asnje rast formatin limit per te cilin eshte konfiguar Plani i Numeracionit.

Nga ana tjeter, ETO ka arritur ne perfundimin qe asnje prej rrjetave te mesiperme nuk kerkon kerkon Numra te Shkurter (pra ka perjashtuar nga mundesia e perdorimit kete lloj te Kodeve te Shkurter), si dhe ne perfundimin se asnje prej Rrjetave jo-telefonike nuk kerkon Kode te Shkurter te Harmonizuar ne nivel European (HESC).

### 1. Rrjetat e te dhenave (*Data Networks*)

Sipas praktikes europiane per kete kod te shkurter zgjedhja e Kodit te Aksesit per keto rrjeta do te behet duke konsideruar:

- Zgjedhja e tyre te behet ne diapazonin e NDC-ve, ne serine "7", e cila se bashku me serine "6" eshte e planifikuar ekskluzivisht vetem per sherbimet/zonat jo-gjeografike.
- Kodi i Shkurter te jete i tipit "Kod Aksesi" me format 3-shifror.
- Kodi i Aksesit te zgjidhet ne diapazonin **7X<sub>1</sub> X<sub>2</sub> (ku X<sub>1</sub>≠0 dhe X<sub>2</sub>=0÷9)**.

Me keto paracaktime, Kodin e Aksesit per "Rrjetat e te Dhenave" e zgjedhim nder elementet qe perfitothen duke zberthyer me nje rend elementin e dyte te serise (elementin 71), dhe konkretisht e caktojme **717**, duke lene nje interval numerik "rezerve" (kodet e shkurter 714, 715 dhe 716), me qellim diferencimin edhe ne pikepamje te numeracionit "vizual" te kesaj kategorie (RRJETA JO-TELEFONIKE), nga kategoria "SHERBIME/RRJETA TE PERZIERA" e trajtuar me siper.

Formati i numrit vijues duhet te respektoje limitin maksimal me 8-shifra te Planit te Numeracionit. Ne kete menyre, formati maksimal i numrit vijues eshte me 5-shifra (YYYYY), i cili mundeson deri 100.000 kombinacione numerike.

Per AKEP rezulton e detyrueshme qe alokimi i ketij Kodi Aksesi per operatoret (si pjese e kushteve te Licences/autorizimeve apo Rregullave te pergjitheshme) te behet pasi te argumentohet perfshirja e nje sherbimi te caktuar telekomunikacioni ne kete kategori Rrjetash.

## 2. Interneti

Sipas praktikes europiane per kete kod te shkurter zgjedhja e Kodit te Aksesit per keto rrjeta do te behet duke konsideruar:

- (a) Zgjedhja e tyre te behet ne diapazonin e NDC-ve, ne serine “7”, e cila se bashku me serine “6” eshte e planifikuar ekskluzivisht vetem per sherbimet/zonat jo-gjeografike.
- (b) Kodi i Shkurter te jete i tipit “Kod Aksesi” me format 3-shifror.
- (c) Kodi i Aksesit te zgjidhet ne diapazonin **7X<sub>1</sub> X<sub>2</sub> (ku X<sub>1</sub>≠0 dhe X<sub>2</sub>=0÷9)**.
- (ç) Ngjashmerine e madhe (nese ekziston realisht ndonje element diferencues) midis “Rrjetave te Internetit” dhe “Rrjetave te Dhenave”.

Me keto paracaktime, Kodin e Aksesit per “Internetin” e zgjedhim **te njejte me ate te “Rrjetat e Dhenave”, pra 717.**

Formati i numrit vijues duhet te respektoje limitin maksimal me 8-shifra te Planit te Numeracionit. Ne kete menyre, formati maksimal i numrit vijues eshte me 5-shifra (YYYYY), i cili mundeson deri 100.000 kombinacione numerike, te cilat per aresye te zgjedhjes se te njejtit Kod Aksesi, do te shfrytezohen ne menyre te perbashket me Rrjetat e Dhenave.

Per AKEP rezulton e detyrueshme qe alokimi i ketij Kodi Aksesi per operatoret (si pjese e kushteve te Licences/autorizimeve apo Rregullave te pergjitheshme), pavaresisht se duket relativisht e lehte, dhe ka eksperience konkrete nga licencimet e deritanishme te ISP-ve, te behet pasi te argumentohet perfshirja e nje sherbimi te caktuar telekomunikacioni ne kete kategori Rrjetash. Nderkohe, aplikimi kodeve te shkurter per rrjetat e Internetit, mund te shoqerohet me nevojën per te ndryshuar ndonje koncept apo praktike te ekzekutuara deri tani.

## 3. Video tekst (*Video text*)

Sipas praktikes europiane per kete kod te shkurter zgjedhja e Kodit te Aksesit per keto rrjeta do te behet duke konsideruar:

- (a) Zgjedhja e tyre te behet ne diapazonin e NDC-ve, ne serine “7”, e cila se bashku me serine “6” eshte e planifikuar ekskluzivisht vetem per sherbimet/zonat jo-gjeografike.

- (b) Kodi i Shkurter te jete i tipit “Kod Aksesi” me format 3-shifror.
- (c) Kodi i Aksesit te zgjidhet ne diapazonin  $7X_1 X_2$  (ku  $X_1 \neq 0$  dhe  $X_2 = 0 \div 9$ ).
- (ç) Ngjashmerine e madhe (nese ekziston realisht ka elemente diferencues) midis ketyre rrjetave dhe “Rrjetave te te Dhenave” apo “Rrjetave te Internetit”.

Me keto paracaktime, Kodin e Aksesit per “Rrjetat Video Tekst” e zgjedhim **te njejte me ate te “Rrjetat e te Dhenave” dhe “Internetin”**, pra **717**.

Formati i numrit vijues duhet te respektoje limitin maksimal me 8-shifra te Planit te Numeracionit. Ne kete menyre, formati maksimal i numrit vijues eshte me 5-shifra (YYYYY), i cili mundeson deri 100.000 kombinacione numerike, te cilat per arsye te zgjedhjes se te njejtit Kod Aksesi, do te shfrytezohen ne menyre te perbashket me “Rrjetat e te Dhenave” dhe “Internetit”.

Per AKEP rezulton e detyrueshme qe alokimi i ketij Kodi Aksesi per operatoret (si pjese e kushteve te Licences/autorizimeve apo Rregullave te pergjitheshme), duhet te behet vetem pasi te argumentohet perfshirja e nje sherbimi te caktuar telekomunikacioni ne kete kategori Rrjetash.

Elementet e pare te serive  $2 \div 9$ , do te zberthehen pas shifres se dyte ne formatin me 3-shifra  $X_1 X_2 X_3$  ku:  $X_1 = 2, 3, 5, 6, 7, 8, 9$ ;  $X_2 = 0$  dhe  $X_3 = 0 \div 9$  (shih “Tabela e alokimit te Kodeve te Shkurter te Sherbimeve”). Kombinacionet me  $X_3 = 0$  ( $X_1 X_2 0$ ) do te perdoren si kode aksesi per sherbimin e “Numrave Personal” (700), per “Telefonat pa pagese” (800) dhe me “Ndarje te ardhurash” (900), ndersa te tjeret (200, 300, 500 dhe 600) do te mbeten te lire, ne dispozicion te sherbimeve te reja qe do te pranohen bashkerisht.

Kombinacionet e tjera te ketyre elementeve te pare me  $X_3 \neq 0$  do te perdoren dhe ne te ardhmen vetem per Kode te Shkurter te tjere, ashtu sikunder aktualisht jane zgjidhur “808” per Sherbimin “Ndarje te Kostos” (*Shared Cost Service*) dhe te tjeret te trajtuar me siper.

			<u>Aneks Nr. 1</u>
			KODET E SHKURTER SIPAS KATEGORIVE TE RRJETAVE / SHERBIMEVE
GRUPI	lir.	EMERTIMI	TIPI I KODIT TE SHKURTER
KODE TE SHKURTER	1	PREFIKSI KOMBETAR ( NATIONAL PREFIX)	PREFIKS
TE HARMONIZUAR	2	PREFIKSI NDERKOMBETRAR ( INTERNATIONAL PREFIX)	PREFIKS
NE EUROPE	3	NUMRI I URGJENCES ( EMERGENCY NUMBER)	NUMER I SHKURTER
( HESCs )	4	KOD AKSESI PER RUBRIKEN E SHERBIMEVE ( DIRECTORY ENQUIRY ACCESS CODE)	KOD AKSESI
	5	5.1 <u>Sherbime te ndryshme te operatorit ( Unspecified operator services )</u>	NUMER I SHKURTER
		5.2 <u>Asistenca e operatorit ( Operator assistance )</u>	NUMER I SHKURTER
SHERBIME TE OPERATORIT		5.3 <u>Njoftimi i defekteve ( Fault reporting )</u>	NUMER I SHKURTER
( OPERATOR SERVICES )		5.4 <u>Kujdesi per Klientin ( Customer care )</u>	NUMER I SHKURTER
		5.5 <u>Thirrje me karte ( Calling card )</u>	NUMER I SHKURTER
		5.6 <u>Telegrame, telekse, fakse ( Telegram, telex, fax )</u>	NUMER I SHKURTER
	6	6.1 <u>Anonçimi i ores ( Speaking clock )</u>	NUMER I SHKURTER
ASISTENCE DHE INFORMACIONE		6.2 <u>Njoftimi i motit ( Weather report )</u>	NUMER I SHKURTER
TE TJERA		6.3 <u>Kujdesi shendetesor dhe social ( Medical/ social care )</u>	NUMER I SHKURTER
( OTHER		6.4 <u>Thirrje per zgjimin ( Wake-up call )</u>	NUMER I SHKURTER
INFORMATION ASSISTANCE )		6.5 <u>Sherbimet e transportit ( Transportation services )</u>	NUMER I SHKURTER
		6.6 <u>Sherbime komunale ( Public utilities )</u>	NUMER I SHKURTER
	7	7.1 <u>Telefon pa pagese ( Freephone )</u>	KOD AKSESI
		7.2 <u>Ndarje te ardhurash ( Shared revenue )</u>	KOD AKSESI
SHERBIME JO - GJEOGRAFIKE		7.3 <u>Ndarje te kostos ( Shared cost )</u>	KOD AKSESI
( NON - GEOGRAPHIC SERVICES )		7.4 <u>Celulari ( Cellular )</u>	KOD AKSESI
		7.5 <u>Pezhinu ( Paging )</u>	KOD AKSESI
		7.6 <u>Numra personal ( Personal numbers )</u>	KOD AKSESI
	8	8.1 <u>Bartesat ( Carriers )</u>	PREFIKS
SHERBIME / RRJETA		8.2 <u>Rrjeta per qellime specifike ( Network - specifics purpose )</u>	KOD AKSESI
TE PERZIERA		8.3 <u>Paragjitja e identifikimit te linjes thirrrese ( Calling Line Identification Presentation - CLIP ) /</u>	NUMER I SHKURTER
( MIXED NETWORKS/ SERVICES )		<u>Kufizimi i identifikimit te linjes thirrrese ( Calling Line Identification Restriction - CLIR )</u>	ose, KOD AKSESI
		8.4 <u>Posta zanore ( Voice mail )</u>	KOD AKSESI
		8.5 <u>Rrjeta Private Virtuale ( Virtual Private Networks - VPNs )</u>	KOD AKSESI
	9	9.1 <u>Rrjetat e te dhenave ( Data networks )</u>	KOD AKSESI
RRJETA JO - TELEFONIKE		9.2 <u>Internet</u>	KOD AKSESI
( NON - TELEPHONY NETWORKS )		9.3 <u>Video text</u>	KOD AKSESI
<p><u>SHEMIM :</u> Per efekt te referencave me burimet e informacionit dhe shprehjen e teaktimitive, eshte caktuar terminologjia edhe ne qelben Analize.</p>			

**Aneks Nr. 2**  
**(faqe nr. 2)**

**SHFRYTEZIMI I NDC-ve GJEOGRAFIKE DHE I BURIMEVE TE SN-ve**  
